



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 03.09.2019

RAPORT

PËR

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, PËR MBROJTJEN SHOQËRORE, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KANADASË”

Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 03.09.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për Ratifikimin e Marrëveshjes, për Mbrojtjen Shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë”. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Klotilda Bushka.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm znj. Anila Denaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë, si edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes, për mbrojtjen shoqërore të emigrantëve, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë. Palët kanë rënë dakord të japin përfitime monetare për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe ato familjare, bazuar në legjislacionet respektive të mbrojtjes shoqërore. Në dispozitat e kësaj marrëveshjeje dypalëshë reflektohen të gjitha rregullat për koordinimin e skemave të mbrojtjes shoqërore, për personat e punësuar, personat e vetëpunësuar dhe për anëtarët e familjeve të tyre, të cilët lëvizin brenda komunitetit, të cilat janë përcaktuar në rregulloren e Këshillit të Parlamentit Evropian (nr.1408/71) dhe të Këshillit Evropian (nr.883/2004).

Dispozitat e marrëveshjes harmonizojnë, gjithashtu, legjislacionet kombëtare të të dyja vendeve për përfitimet që kanë të bëjnë me sëmundjet, barrë lindjet, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore. Gjithashtu, rregullat koordinuese garantojnë që personat që lëvizin nga një vend në tjetrin dhe personat në varësi të tyre e të mbijetuarit, të ruajnë të drejtat e fituara apo që janë duke i fituar.

Për vetë veçoritë e administrimit territorial dhe juridik të Kanadasë, në nenin 25 të projekt marrëveshjes përcaktohet se Shqipëria mund të realizojë marrëveshje me çdo provincë në Kanada, për çështje të mbrojtjes shoqërore, me kusht që ajo të mos jetë e papajtueshme me këtë marrëveshje.

Dispozitat e marrëveshjes respektojnë Kushtetutën dhe parimet e saj. Gjithashtu, ato respektojnë dhe zhvillojnë të drejtat e fituara në koherencë me zhvillimet ekonomike e financiare të vendit. Këto dispozita respektojnë parimet buxhetore të financimit të shpenzimeve të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, si edhe të dispozitave ligjore në fushën e administrimit financiar e kontrollit.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore, e cila synon synon përfitime monetare për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe ato familjare, bazuar në legjislacionet respektive të mbrojtjes shoqërore.

Një çështjet tjetër e diskutuar në komision lidhet me pyetjen e deputetes Bushka nese ka ndonjë të dhënë Ambasada apo Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi strukturën moshore të 60 mijë emigrantëve shqiptarë në Kanada. Sepse Marrëveshja parashikon që efektet financiare do të fillojnë pas 6-10 vjetësh, duke arsyetuar se shumica e emigrantëve janë në moshë të re, në një kohë që mund të ketë individë që mbushin moshën e pensionit që këtë vit. Në këtë aspekt, përfaqësuesit e Ministrisë sqaruan se marrëveshja nuk do të ketë efekte financiare në vitet në vijim.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) **Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KLOTILDA BUSHKA

KRYETARI

ULSI MANJA